**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ROSKOVEC**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 6901 prot

Roskovec, më 19/10/2021

**VENDIM**

**NR 85 .DATË 18.10.2021**

***"PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "NDËRTIM I KOMISARIATIT TË POLICISË ROSKOVEC" "NDËRTIM I UNAZËS SË RE (LINDORE) ROSKOVEC"***

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 9 pika 1.2 gërma b); ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" nenet 7, 8 gërma ç, 9/1, 10 pika, gërma c, 11, 17 dhe 19; VKM nr. 138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar; VKM nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë;Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1. Shpronësimin e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga zbatimi i projektit "Ndërtim i Komisariatit të Policisë Roskovec", "Ndërtim i unazës së re (lindore) Roskovec" .
2. Miratimin e vlerës së shpronësimit të pasurive të sipërcituara sipas listës bashkëlidhur.
3. Fondi për këtë qëllim do të përballohet nga fondi i caktuar në zërin "Shpronësime për interes publik" i planifikuar në buxhetin e Bashkisë.
4. Ngarkohet Komisioni i Shpronësimit me zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**
**Kadri Hyska**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ROSKOVEC

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ROSKOVEC**
**KOMISIONI I SHPRONËSIMIT**

Nr.6728/prot
12

Roskovec ,më 12.10.2021

Lënda: Relacion mbi projekt-vendimin "Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive tw paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtim i Komisariatit të Policisë Roskovec", "Ndërtim i unazës së re (lindore) Roskovec".

**KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC**

**Roskovec**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 9 pika 1.2 gërma b); ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" nenet 7, 8 gërmaç, 9/1, 10 pika, gërma c, 11, 17 dhe 19; VKM nr. 138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar; VKM nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë;

Paraqesim për diskutim e miratim shpronësimin e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga zbatimi i projektit "Ndërtim i Komisariatit të Policisë Roskovec", "Ndërtim i unazës së re (lindore) Roskovec" sipas listës bashkëlidhur.
Sipas tabelës bashkëlidhur këtij projekt-vendimi ju paraqesim për diskutim e miratim vlerën e shpronësimit.

**Komisioni:**

**M. Goga** **R. Hazizaj** **A. Dukaj** **D. Fejzulla** **E. Toro**

**KRYETAR**
**Majlinda Bufi**

**Lista e pronarëve, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit**
***"Ndërtim i unazës së re (lindore) Roskovec"***

| *Nr* | *Emër Atësi Mbiemër* | *Nr. Pasurisë* | *Zk* | *Sip. e Parcelës Sipas Kartelës Së Pronësisë $m^2$* | *Sip. e Tokës Së Prekur $m^2$* | *Cmimi Lekë/$m^2$* | *lloji i pasurisë* | *Vlera Totale Lekë* | *Shënime sqaruese* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *1.* | *Servet Dervish Pirra* | *352/13* | *3196* | *3687m2* | *590 $m^2$* | *494* | *truall* | *291 460 Lekë* | *Certifikatë Pronësie* |
| *2.* | *Gëzim Servet Pirra* | *352/18* | *3196* | *2000$m^2$* | *327$m^2$* | *494* | *truall* | *161 538 Lekë* | *Certifikatë Pronësie* |
| *3.* | *Asqeri Dyle (bashkëpronarët)* | *349/10* | *3196* | *7600 $m^2$* | *1407$m^2$* | *494* | *truall* | *695 058 Lekë* | *Certifikatë Pronësie* |
| Vlera totale paraprake | | | | | | | | **1 148 056** *Lekë* | |

**Komisioni:**

**M. Goga** **R. Hazizaj** **A. Dukaj** **D. Fejzulla** **E. Toro**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA ROSKOVEC

**KRYETAR**
**Majlinda Bufi**

Lista e pronarëve, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit

*"Ndërtim i komisariatit të policisë Roskovec"*

| *Nr* | *Emër Atësi Mbiemër* | *Nr. Pasurisë* | *Zk* | *Sip. e Parcelës Sipas Kartelës Së Pronësisë $m^2$* | *Sip. e Tokës Së Prekur $M^2$* | *Cmimi Lekë/$m^2$* | *Lloji i pasurisë* | *Vlera Totale Lekë* | *Shënime sqaruese* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *1.* | *Servet Dervish Pirra* | *352/13* | *3196* | *3687$m^2$* | *1801 $m^2$* | *494* | *truall* | *889 694 Lekë* | *Certifikatë Pronësie* |
| *2.* | *Gëzim Servet Pirra* | *352/18* | *3196* | *2000$m^2$* | *857$m^2$* | *494* | *truall* | *423 358 Lekë* | *Certifikatë Pronësie* |
| Vlera totale paraprake | | | | | | | | 1 313 052 Lekë | |

**Komisioni:**

**M. Goga** **R. Hazizaj** **A. Dukaj** **D. Fejzulla** **E. Toro**

**KRYETAR**
**Majlinda Bufi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC